

dhe Hazirit. Burimin e kanë varrosur në Suharekë/Suva Reka, ndërkaq Hazirin në Vraniq/Vranić. Pas përfundimit të luftës, mbetjet mortore të Hazirit u rivarrosën në varrezat në Budakovë/Budakovo.

**Burimet:** deklarata R.E, FDH-32477; deklarata Z.B, FDH-11220; deklarata N.N, FDH-3652; deklarata N.N, FDH-3655; deklarata N.K, FDH-6781; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.241 A, FDH-5838; KMDLNJ, *Bulletini*, nr.9, tetor-dhjetor 1998, 5, 23, FDH-23857; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.6D00701, FDH-35931; J. Osmani, *Krimet...*, 355; TMK, Vertetim për deshmorë të ushtrisë clirimtare të Kosoves, FDH-36831; UÇK, *Lista e deshmorëve...*, FDH-36427.

### Hafir (Nezir) Elshani

(10.06.1963, shqiptar nga Sllapuzhani/Slapuzane, komuna e Suharekës/Suva Reka, tregtar, i martuar, pjesëtar i UÇK-së)

### Milaim (Bajram) Bugari

(24.11.1969, shqiptar nga Peqani/Peçane, komuna e Suharekës/Suva Reka, punëtor ndërtime, tre fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Hafiri ka qenë i angazhuar në transportimin dhe ruajtjen e armatimeve që nga viti 1997. Nga muaji shkurt i vitit 1998, ka marr pjesë në organizimin e rojës dhe hapjen e bunkerëve dhe istikameve në fshat. Për detyrë e kishte kontrollimin e dy pozicioneve të UÇK-së: *Të Drita* dhe *Qukarke*. Në datën 25.09.1998, e kanë risistemuar si përforsim në **Vraniq/Vranić**. Milaim Bugarin, po ashtu, e kanë dislokuar si përforsim të mbrojtjes në Vraniq/Vranić. Rreth orës 17:00, më **28.09.1998**, Hafiri dhe Milaimi kanë rënë në betejë me forcat serbe të *Maja e Ahishtës/Bukvin vrh*. Ditën e nesërme, më 29.09.1998, vëllai i Hafirit me disa ushtarë të UÇK-së i kanë bartur trupat në xhaminë e fshatit në Vraniq/Vranić. U varrosën më 1.10.1998 në varrezat e fshatit. Pas përfundimit të luftës, më 18.09.1998, mbetjet mortore të Hafirit dhe Milaimin u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Suharekë/Suva Reka.

**Burimet:** deklarata H.E, FDH-32547; deklarata N.N, FDH-3651; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.241 A, FDH-5838; KMDLNJ, *Buletini*, num.9, tetor-dhjetor 1998, 114, FDH-23857; fotografi, FDH-20988; fotografi, FDH-20985;

fotografi, FDH-19086; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; UÇK, *Lista e deshmorëve...*, FDH-36427.

### Željko (Stamenija) Jovičić

(25.12.1966, serb nga Sopot, i pamartuar, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

### Nebojša (Radivoj) Jevtić

(09.09.1968, serb nga Shabaci, dy fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

### Saša (Zoran) Simeunović

(15.08.1969, serb nga Duçina, komuna e Sopotit, dy fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Pas përfundimit të shkollës së mesme për punë të brendshme, Željko u punësua në shërbimin policor të Sopotit. Gjatë vitit 1998, shpesh e çonin me detyrë në Kosovë. Nebojša me bashkëshorten dhe fëmijët jetonin në Shabac, ndërkaq ai punonte në shërbimin policor të Obrenovacit. Saša jetonte në bashkësinë familjare me prindërit e vet, bashkëshorten dhe dy fëmijë në fshatin Duçina, në afërsi të Sopotit. Nga viti 1988, punonte në shërbimin policor të Vozhdovacit [Beograd].

Në pasditen e datës **28.09.1998**, Željko, Nebojša dhe Saša gjendeshin në përbërje të autokolonës, e cila u ndal në afërsi të **Budakovës/Budakovo**. Pas pushimit të shkurtër, ata u caktuan në përbërje të një grupi policësh, i cili e kishte për detyrë ta kontrollonte një breg përkaj rrugës. Duke lëvizur drejt bregut, ata hasën në pjesëtarë të UÇK-së, të cilët menjëherë e hapën zjarr ndaj policëve serb. Željko dhe Saša gjetën vdekjen në vend, ndërkaq Nebojša u plagos rëndë. Ka dhënë shpirt në rrugë për në spitalin e Prizrenit/Prizren. U varrosën më 30.09.1998: Saša në varrezat e Duçinës, Željko në varrezat e Sopotit, ndërkaq Nebojša në varrezat e fshatit të lindjes së Matijevcit.

**Burimet:** deklarata R.S, FDH-25988; deklarata D.O, FDH-26094; SMIP, *Teroristički...*, III, 525-531, 941; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 31, 33 i 62; M. Sekulić, *Beograd...*, 42 i 44; Gjykata e Qarkut Prokuplje K.nr. 95-99 (Gzim Loshi dhe të tjerë), aktgjykimi, 9.11.1999, FDH-2064.